

S T A T U T I
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
„ Roy&CO“ SH.P.K

EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

Neni 1
Themelimi

Sot më 02 Tetor 2023

Themelohet Shoqëria tregtare “Roy&CO” sh.p.k si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në zbatim të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” nga ortaku i mëposhtem:

- 1- *Renald Mjekra* lindur në Tiranë më 16.09.1995 dhe banuese në LUKOVE 03840294; Nd. 6; H. 1; KAMËZ; LAKNAS; 1030; KAMËZ, Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i dokumentit identifikues Karte Identiteti nr. J50619132J

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

Kjo shoqëri fiton zotesinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, qëndër e cila pas miratimit të regjistrimit të shoqërisë e pajis atë edhe me NUIS-in përkatës identifikues.

Neni 2
FORMA DHE EMERTIMI

2.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë asambleja e ortakeve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.

2.2.Emërtimi i shoqërisë është “Roy&CO” *sh.p.k*,..

Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet Sh.p.k.



NENI 3
BAZA JURIDIKE

4. Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 4
SELIA

5.Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë.

Ne adresen: Rruga Rreli, Pallati Anresli, Kati i pare,zr.3, Selite, Farke, Tiranë, dhe mund te ndryshojë seline e saj me vendim të ortakeve.

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

1) shoqëria ka për objekt:

Murature, Suvatime, Karpenteri, rikonstruksione, skeleri, sisteme kapot, e pllake dhe murature.Ne fushen e ndertimit dhe shitjes se banesave te qytetareve, objekte industriale, social-kulturore, bujqesore, turistike, hoteleri, ujesjellesa, punime restaurime, punime te dheut, murature, punime betoni dhe beton arme, punime te shembjes, kompletimin me instalime te brendshme objekteve te ndertuara, marrjen dhe dhenjen me qira te pajisjeve te ndertimit, te mjeteve te transportit per ndertimin dhe tregtimin e tyre..


Ndertime dhe mirmbajtje e llojeve te ndryshme, banesa dhe godina social kulturor Punime per ndertimin dhe mirmbajtjen e rrugeve automobilistike dhe infrastruktures rrugore. Ndertime dhe mirmbajtje e veprave civile dhe industrial, ndertimin e ndertesave publike dhe private, punime restaurimi.

Mirmbajtje e ambjenteve te gjelbra (sistemim lulishte, vepra arti dhe dekori).

Shoqeria kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj.

Kompania gjithashtu mund të kryeje të gjitha transaksionet tregtare dhe financiare dhe të zbatoje te gjitha nismat qe lidhen me arritjen e objektivave sociale, duke perfshire te gjitha aktivitetet qe lidhen me pronen e luajtshme dhe te paluajtshme.

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.



NENI 6 KOHËZGJATJA

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 7 TERRITORI

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI III AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI

NENI 8 FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT

8.1 Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

NENI 9 LIBRI I SHOQËRISË

9.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

NENI 10 KONFIDENCIALITETI

10.1 Ortaket e shoqërisë si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 11 DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

11.1 Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxiren nga Shoqëria dhe janë të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet, publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm

emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “SH.P.K”, si dhe emrin e administratorit.

NENI 12

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESËT DHE TRANSFERIMI I TYRE

12.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në **Leke 200 000 Leke** (Peseqinde mije leke)

12.2 Kapitali themeltar është i ndarë në 1(një) kuota.

12.3 Ky kapital themeltar i shoqërisë është i zotëruar nga Ortaket si me poshte

- 2- *Renald Mjekra* lindur në Tiranë më 16.09.1995 dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i dokumentit identifikues Karte Identiteti nr. J50619132J, ***zoterues i 1 (një) kuote me vlerë nominale Leke 200 000 Leke*** (dyqinde mije leke) e barabër me ***100% te kapitalit te shoqërisë. Ortaku ka të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të paksojë kuotat e kapitalit deri në kufinj të percaktuara nga ligji***

Kalimi dhe fitimi i kuotave të shoqërisë do të bëhet në përputhje me nenet 72- 75 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

12.5 Kapitali fillestar i shoqërisë nuk ***është paguar***.

Neni 13

Transferimi i kuotave dhe zmadhimi i kapitalit

- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, apo ndarje pasurore mes bashkëshortëve.
- Transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar si trashëgimni ose brenda familjes personave perfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë permbajtjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që ai mund të ketë pësuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar të bëhen lehtësisht të transferueshme.
- Në rast mospranimi, pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e ortakeve

Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar të secilit ortak themelues, në persona të tjerë jo ortake të shoqërisë do të bëhet vetëm me miratimin e Asamblese së Ortakeve. Në çdo rast ortakut që kërkon të largohet nga shoqëria, duhet të respektojë të drejtën e parablerjes së kuotave nga ortakët themelues të shoqërisë. Në rast se kuotat e ortakut themelues janë të tilla që kanë një çmim tregu të ndryshueshem do të merret si çmim i pranuar çmimi me i lartë i shitjes, çmim i konfirmuar me garanci oferte të verifikueshem nga pjesëmarrësit e Asamblese së shoqërisë. Në rast vdekjeje të ndonjë prej ortakëve të shoqërisë trashëgimtarët e tij apo rast

ndarje pasurore midis bashkeshorteve, subjektet perfitues sipas ligjit kane të drejtë të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit te shoqerise ose për vazhdimin e veprimtarisë sipas parashikimeve ne ligj nepermjet trashegimise dhe pjesmarrjes se trashegimtareve ligjore ne shoqeri apo bashkepjesmarrjes nga ndarja e pasurise bashkeshortore. Ortaket e kësaj shoqërie, mund të vendosë të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që e sheh të nevojshme. Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe nenit 81 te Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

ORGANI DREJTUES **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

NENI 14

Asambleja e Ortakeve

Secili aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e mbledhjes së aksionarëve dhe mund të ketë një numër votash të barabarta me aksionet e kapitalit të zotëruar.

Një anëtar mund të përfaqësohet në një mbledhje të përgjithshme në bazë të një delegimi nga një partner tjetër, bashkëshorti ose personi tjetër i caktuar prej tij, me kusht që të autorizohet nga një prokurë.

Asambleja e ortakeve perbehet nga mbledhja e 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise. Ajo mblidhet me kerkesen e Administratorit. Gjithashtu secili prej ortakeve ka te drejte t'i paraqese Administratorit kerkese me shkrim per mbledhjen e asamblese te pergjithshme duke treguar ne te arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Ne rast se kërkesa refuzohet, ortaku kanë të drejtë te thërrase asamblenë dhe të caktojë çështjet e rendit të ditës.

Permbajtja dhe rendi i dites iu njoftohet ortakeve te pakten 7 dite perpara mbledhjes se Asamblese, ne rastin e shoqerise njoftimi iu behet te ditur te gjithe ortakeve themelues. Mbledhja quhet e vlefshme kur me nje nga menytrat e percaktuar ne ligj, eshte bere njoftimi i ortakeve te shoqerise (pjesmarresve te themeluesve), me konfirmim shkresor duke percaktuar edhe rendin e dites se mbledhjes. Ne rast se pjesmarresit marrin pjese personalisht ata do te konsiderohen te njoftuar pavarsisht nese nuk ka konfirmim me shkrim. Pjesemarresi ne mbledhje mund te jete vete ose te perfaqesohet nga nje tjetër person te caktuar me Prokure perfaqesimi, duke patur te shprehur objektin e mbledhjes ne mbledhjen e Asamblese.

Vendimet e asamblese te cilat merren me shumice te thjeshte do te jene te vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Vendimet te cilat merren me shumice te kualifikuar do te jene te vlefshme vetëm nëse jane te pranishem ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave. Do te meren me shumice te kualifikuar prej $\frac{3}{4}$ te kuotave pjesmarse vendimet per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Te gjitha vendimet e tjera do te meren me shumice te thjeshte.

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregëtare të Shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likujdësve dhe eksperteve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kësaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimtarisë ;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l) Krijimin e fondeve, përbërjen, madhësinë, burimet e krijimit, mënyra dhe kushtet e përdorimit.
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mbledhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen sa herë çmohet e nevojshme nga ortaket.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket sipas nenit 84 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

NENI 16

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e Ortakeve ka për kompetencë :

Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçante të veprimtarisë.

-Te emerojë apo shkarkojë Administratorin e shoqërisë, pronar ose jo pronar.

-Të japë ose jo pelqimin për caktimin e ekspertit kontabël nga Administratorët e shoqërisë, i cili do të bëjë auditimin e vitit ushtrimor;

-Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentacionin e saj ;

- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej saj ose te kerkuar nga çdo ortak ;
- Te jape ose jo miratimin per marrjen e çdo lloj huaje apo kredie bankare.
- Te jape ose jo miratimin per shtimin e kapitalit apo pakesimin e tij.
- Te vendose per miratimin ose jo te largimit te ortakut ne rast te shitjes se kuotave dhe zevendesimin e tij me nje person tjetër.
- Kompetenca te tjera që parashikohen ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË
NENI 17
ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

Kompania mund të administrohet nga administratori i vetëm ose administratorët e shumtë, të cilët mund të jenë persona fizikë të emëruar brenda komunitetit ose jashtë këtij komuniteti. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rimerimi. Emërimi i administratorit jep efekte ligjore vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori i një shoqërie tregëtare mëmë, nuk mund të emërohen si administrator i kësaj shoqërie.

Administratori të detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregëtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm që ushtron detyrat e Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Në rastet e parashikuara nga statuti dhe në rastet e tjera te parashikuara në ligj, administratori është i detyruar të paraqese raport te ortaku i vetëm apo të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rast se do të ketë shtim të ortakëve të shoqërisë.



Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

- 3- Administrator i shoqërisë është – *Renald Mjekra* lindur në Tiranë më 16.09.1995 dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i dokumentit identifikues Karte Identiteti nr. J50619132J, me afat emërimi për 5 vjet me të drejtë riemërimi.

LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI , DIVIDENTET

NENI 18

LIBRAT E SHOQËRISË

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

NENI 19

BILANCI

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortaku i vetëm.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 20

DIVIDENTET

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe duke theksuar ekzistencën e fitimeve, mbledhja e aksionarëve përcakton pjesën e anëtarëve në formën e dividendëve mbi fitimet, në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit aksioner në kompani. Fitimet që do të shpërndahen midis anëtarëve në përpjesëtim me aksionet e kapitalit të kompanisë, përbëhen nga fitimi i vitit në të cilin janë zbritur shumat e rezervuara për fondin e domosdoshëm të aksioneve (5% të fitimeve) të secilit vit, derisa ky fond arrin vlerën 1/10 të kapitalit të kompanisë) dhe, nga ana tjetër, humbjet ose të ardhurat e mbajtura nga vitet e mëparshme zbriten ose rriten respektivisht.

MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

NENI 21

MBARIMI

22.1 Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

NENI 22 LIKUJDIMI

23.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, ortakët vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit. Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA E FUNDIT

NENI 23 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare, pasi të jete ezauruar mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirkuptim midis ortakëve.

NENI 24 DISPOZITA E FUNDIT

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga Ortakët e shoqërisë.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë , me 02.10.2023

ORTAKU I VETEM

Renald Mjekra

RENALD MJEKRA